



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ROSKOVEC
NJËSIA E PROKURIMIT

Nr. _____ Prot.

Roskovec, me _____

PROCESVERBAL- Tipi i kontratës - Shërbime
PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM
(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS: "Pjesë kembimi, goma, bateri dhe mirëmbajtje mjetesh".

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

Pjesë këmbimi për automjete, furgonë dhe makina transporti mallrash – 34330000-9

Shërbime riparimi gomash, përfshirë montimin dhe balancimi – 5011650-6

VLERA E FONDIT LIMIT: 1 181 000 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e një mijë) lekë pa tvsh.

Argumentimi i fondit limit: Komisioni i llogaritjes fondit limit dhe specifikimeve teknike për llogaritjen e fondit limit i është referuar nenit 76 të pikës 2 germa (b) të VKM-së me nr.285, datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar, që përcakton “studimin e tregut, bazuar në mesataren e çmimeve të marra nga ky studim”, çmimet i ka bazuar te studimi i tregut bazuar kjo në mesataren e çmimeve të marra nga studimi që ka kryer komisioni i llogaritjes së fondit limit dhe specifikimeve teknike (KLLFLST). Nga ofertat e marra nga subjektet që operojnë në aktivitete të ngjashme me objektin e këtij prokurimi, komisioni ka vendosur çmimet në bazë të mesatares së ofertave, me qëllim që vlera limit e kontratës, të jetë një vlerë reale për kushtet e tregut dhe njëkohësisht e të krijojë mundësinë e pjesëmarrjes së sa më shumë operatorëve ekonomikë. **(Dokumentuar me relacionin shpjegues të KLLFLST nr. 1375/2 prot datë 20.02.2025)**

Në bazë të nenit 21 pika 2 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, nenit 2 pika 2/c dhe nenit 78 pika 2 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Roskovec ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

a. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 9;

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 4;

Argumentimi: Pika 1.a Kërkesa për Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit bazohet në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 26 i VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Pika 1.b Kërkesa e mësipërme për sigurimin e ofertës mbështetet në Ligjin Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar neni 83 pika 1 si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni II, Neni 30 pika 1.

Këto kritere janë vendosur për të vërtetuar pjesëmarrjen ose jo të operatorit ekonomik në tendera, duke paraqitur oferte. Gjithashtu këto kritere janë vendosur edhe për të vërtetuar deklaratimet dhe dokumentat e paraqitura nga operatorët ekonomik, duke kaluar tërësisht përgjegjesinë administrative ose penale gjithashtu barrën e proves tek operatorët ekonomik për dokumentat e paraqitura.

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Plotësimi i kapaciteteve ligjore nga operatorët ekonomikë dhe vërtetimi se ata kanë zotësi juridike për të lidhur kontrata prokurimi, bëhet me anë të paraqitjes prej tyre të deklaratës mbi përmbushjen e kritereve të përgjithshme, sipas shtojcës 7 dhe 8.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenin 14 pika 2 dhe 77 pika 1/a dhe 2 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; nenin 39 pika 6/b dhe nenin 88 pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Ky kriter vendoset për të vërtetuar që operatori ekonomik pjesëmarrës ka eksperiencën e duhur dhe kapacitetin potencial ekonomik.

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2021, 2022 dhe 2023, ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40% e vlerës së perlogaritur të kontratës, **perkatesisht 472 400 lekë pa tvsh.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77 pika 3 e Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar si dhe nenin 43 pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë: Vendosija e këtij kriteri kualifikues i sherben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zoteron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilanci vjetore për vitet financiare 2021, 2022, 2023 të shoqëruara me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve në përputhje me Ligjin nr.10091 datë 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabel të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, Kreu V, neni 41, pika c.

Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 pika 3 e Ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe në nenin 43 pika 4 të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës

konkretisht, Ligjit nr. 10091 date 05.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” i ndryshuar. Autoriteti Kontraktor mund të kërkojë nga OE pjesëmarrës në një procedurë prokurimi të japin informacione në bilanci të tyre vjetore, për një periudhë maksimumi tre vitet e fundit financiare, që të tregojë raportet nëpërmjet aktivitetit dhe pasivitetit. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, Ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat” i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar nenit 29 të ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore” i ndryshuar: *“Çdo tatim-pagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatim-paguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilanci kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në Udhëzimin e Ministrit të Financave, në zbatim të këtij ligji”*.

2.2.3 Vërtetim për shlyerjen e taksave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin 2024 në zbatim të Ligjit Nr.9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” i ndryshuar. (Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës në të cilën është regjistruar sipas QKB).

Ky kriter përmbushet nëpërmjet paraqitjes së Formularit përmbledhës të Vetedeklarimit sipas shtojcës 9 në DST.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, Nenin 43 pika 6 të VKM-së Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar si dhe sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar që operatorët ekonomikë nuk kanë pagesa të pashlyera të taksave dhe tarifave vendore.

2.3 Kapaciteti teknik:

Për të provuar përvojën e mëparshme operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi dëshmi për furnizime të ngjashme të kryera gjatë tre viteve të fundit ku vlera e kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës perkatesisht: **236 200 leke pa TVSH.**

2.3.1 Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë faturën përkatëse tatimore të shitjes të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi dhe të deklaruara në organet tatimore, ku të shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Per kontratat e realizuar si Bashkim Operatoresh, operatori ekonomik ofertues duhet te paraqese: Kontraten e bashkimit te operatoreve te deklaruar ne fazen e tenderimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe në nenin 55 pika 4/b të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përllogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë: Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garantojnë autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës shërbimeve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1, 3 e VKM 285/2021 i ndryshuar, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve. AK argumenton se furnizimet e mëparshme të ngjashme është kërkesë, e cila shërben për të vlerësuar përvojën e duhur të Ofertuesve. Vlerësimi i përvojës realizohet duke paraqitur dokumentat e kërkuara sipas pikave (pika a dhe b të cilat vërtetojnë eksperiencën në realizimin e shërbimeve publike/private të ngjashme, si dhe janë një garanci më shumë për Autoritetin Kontraktor me qëllim përmbushjen me sukses të kontratës objekt prokurimi.

2.4 Operatori Ekonomik pjesëmarrës duhet të ketë të punësuar punonjës të specializuar si:

1 (një) specialist-motorist, 1 (një) specialist-elektroaut, 1 (një) specialist- xhenerik të cilët duhet të figurojnë në listpagesat e shoqërisë minimumi per periudhen e fundit te deklaruar.

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatori ekonomik duhet të vetëdeklaroj disponimin e punonjësve në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, Shtojca 9.

Ndërsa operatori ekonomik fitues përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si më poshtë:

1. Kontrata e punës e vlefshme
2. CV të specialistit
3. Dëshmi/Certifikatë kualifikimi.

Argumentimi: Është kërkuar ky numër mesatar punonjësish si dhe periudha për të parë nëse operatorët ekonomik kanë kapacitetin e duhur për të përmbushur shërbimet e pershkuara në preventiv brenda afatit të caktuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë stafin, personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77 pika 1/a dhe 2 të LPP i ndryshuar, nenit 41 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Konkretisht: Referuar natyres se shërbimeve që kërkohen të prokurohen sic janë riparime dhe mirëmbajtje të agregatit të motorrit, të karrocërve, të sistemeve të drejtimit, frenimit, kondicionimit, amortizimit etj është e nevojshme pasja e një stafi teknik me profesione si motorrist, xhenerikë, elektroaut e vertetuar kjo në baze të kontratave të punës si dhe të deklaratës së plotësuar nga operatori ekonomik me qëllim realizimin me sukses të kontratës. Bazuar në parashikimet e mësipërme të legjislacionit për prokurimin publik, Autoriteti Kontraktor ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të ketë në stafin e tij punonjës të aftë profesionalisht për realizimin e objektit. Kërkesa e AK që OE duhet të ketë në stafin e tij specialist motorrist, specialist elektroaut dhe xhenerik është në funksion të realizimit të kontratës duke patur parasysh zërat përkatës të shërbimeve për secilin automjet si dhe kualifikimin e duhur profesional që duhet të kenë specialistët që do të kryejnë diagnostifikimin dhe riparimin e tyre. Referuar zërave të shërbimeve të kërkuara në preventivin e hartuar nga KLLFLST për secilin automjet, duket qartazi domosdoshmëria për specialistët e nevojshëm të cilët kanë aftësinë dhe formimin profesional dhe që janë specializuar për t'i kryer ato. Numri i përcaktuar i punonjësve është për llogaritur si më poshtë: Duke iu referuar zërave analitikë të parashikuar në specifikimet teknike për shërbimin e mirëmbajtjes së automjeteve, sqarohet se objekti i kontratës do të jetë mirëmbajtja e automjeteve të AK. Në varësi të aktivitetit që ato kryejnë, shërbimet do të kërkohen nga AK që të kryhen për secilin automjet në kohë të ndryshme dhe jo njëherësh. Kështu që OE kontraktor do të mjaftonte që të ketë të punësuar jo më pak se 3 punonjës në mënyrë që të përmbushë realizimin e shërbimit të kërkuar në çdo kohë dhe se ky numër është i domosdoshëm dhe i mjaftueshëm që të gjitha nevojat e AK për shërbimin e mirëmbajtjes së automjeteve të përcaktuar do të bëhet në kohë dhe me cilësinë e duhur. Për sa i përket dokumentacionit si CV apo Dëshmi/Certifikatë kualifikimi kërkohej për të parë nëse stafi ka eksperiencën, aftësinë për të përmbushur sa më mirë punët e kërkuara sipas specifikimeve teknike.

2.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës me qëllim kryerjen e shërbimeve objekt prokurimi, duhet të **disponojë 1 (një) servis automjeteve në pronësi ose me qera** që plotëson këtë kusht gjeografik, **jo më larg se 30 km nga territori i Bashkisë Roskovec**, ku për vërtetimin e përmbushjes së këtij kushti duhet të paraqesë:

- Dokumentacionin që vërteton pronësinë (dhe kontratën noteriale të qirasë me kohëzgjatje në përputhje me afatin e kontratës, në rast se servisi është me qira)
- Foto në plan të ndryshme (të paktën 2)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 pika 5ç, 6.b dhe 8, të VKM-së nr. 285, datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar. Ky vetdeklarim kërkohej për të vërtetuar dhe garantuar AK-së realizimin me sukses të kontratës për sa i përket zbatimit të objektit prokurimi.

2.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë mjetet dhe pajisjet e mëposhtme:

Për përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të vetëdeklarojnë mjetet dhe pajisjet që disponojnë në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, konkretisht:

a- OE duhet të disponojë ura ngritëse dhe gropa kontrolli

b- Operatori ekonomik duhet të jete i pajisur me karrotrec në pronësi ose me qera.

Operatori ekonomik fitues përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese si më poshtë:

- a- Çertifikata e pronesise se objektit (servisit te automjeteve) ose kontrata e qera-marrjes se objektit.
- b- Për mjetet që shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet dokumentacioni që verteton pronesinë e mjetit:
 - çertifikatën e pronesise;
 - leja e qarkullimit;
 - çertifikatën e kontrollit teknik;
 - siguracionin;
 - leja e transportit e vlefshme
 - fotot perkatese;
- c- Ndersa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të kontratës.
- d- Për mjetet që nuk shënohen në regjistra publikë, kur janë në pronesi, duhet të paraqitet kontrata e blerjes ose fatura e zhdoganimit ose fatura tatimore perkatese, fotot, ndersa për mjete të marra me qira krahas dokumentacionit të mesipër, duhet të paraqitet edhe kontrata e qirase e cila duhet të përfshijë objektin perkates dhe duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën deri në përfundimin e plotë të punimeve.
- e- Për mjetet dhe pajisjet teknike që ka deklaruar operatori ekonomik duhet të paraqesë foto të qarta për secilin mjet dhe pajisje. Në rastin e mjeteve të treguara duhet të jetë e dukshme në një foto të vetme mjeti dhe targa e tij.

Argumentimi: Në bazë të nenit të 77 pika 4 e ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar dhe nenit 41 pika 4/ ç të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion mjetet dhe pajisjet teknike për të përmbushur kontratën, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit. Ky kriter është vendosur me qëllim verifikimin gjendjes fizike të urave ngritese dhe dokumentacioni është kërkuar me qëllim për të vertetuar që OE disponon ura ngritese dhe gropa kontrolli në pronesi ose me qera të operatorit ekonomik dhe me dokumenta të rregullta. AK kërkon që OE duhet të disponojë ura ngritese dhe gropa kontrolli të nevojshme në riparimin e automjeteve, ato detyrimisht duhet të ngrihen në urë vinç që të kryhet shërbimi i kërkuar. Kërkesa që OE duhet të disponojë një automjet karroatrec, i cili do të jetë i nevojshëm nëse ndonjë prej automjeteve të AK gjatë aktivitetit ditor pëson ndonjë defekt të mundshëm dhe si pasojë e kësaj nuk mund të shkojë vetë pranë pikës së servisit të OE kontraktor. Ky kriter vendoset gjithashtu me qëllim për të reduktuar koston e transportit të mjeteve të demtuara që cohen në servis e marrjen e shërbimit në një kohë sa më të shpejtë. Si dhe nisur nga fakti se objekt i kësaj kontrate është riparim dhe mirëmbajtje e automjeteve, ndër të cilat mund të ndodhë që në rast të caktuar duhet të transportojnë një automjet të difektuar në ambientet e servisit që disponon OE, është e domosdoshme që operatorët ekonomik duhet të dëshmojnë që kanë minimalisht, 1 (një) automjet, konkretisht karroatrec me qëllim realizimin të objektit të prokurimit.

2.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë një deklaratë me anë të së cilës merr përsipër të kryejë shërbimin e transportit për mjetet nga adresa e autoritetit kontraktor (vendi ku mund te prishet automjeti) deri në servis, si dhe të pjesëve të këmbimit.

Argumentimi: Me anë të kësaj deklarate synohet që ne rast se AK-se do t'i lind nevoja për riparime të mjeteve në vende ku mjeti që mund të peshojë defekt mund të transportohet vetëm me karrotrec, Operatori Ekonomik do të jetë i gatshëm të kryejë shërbimin e transportit të automjetit në servis.

2.8 Referuar pikës 1, të nenit 26, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, ku parashikohet : *“Bashkë me dorëzimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoriteti/enti kontraktor pranon si provë paraprake, në vend të disa vërtetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose palë të treta, formularin përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas përcaktimit në nenin 82, të LPP-së, dhe në këto rregulla”*, si dhe përcaktimet e pikës 6 të këtij neniku parashikohet: Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese të parashikuara në shkronjat “a”, “b”, “d”, “dh”, “e”, “h”, “i”, “j” të pikës 2 të këtij neni, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 26 pika 1 e VKM-së, nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar .

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

U ra dakort nga antaret e Njesisë së Prokurimit të ngritur me urdher të titullarit të autoritetit kontraktor **nr.43 prot date 21.02.2025**, për këto kërkesa për kualifikim pasi kërkesat e mësipërme janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës që është: **“Pjesë këmbimi, goma, bateri dhe mirembajtje mjetesh”** me fond limit prej: **1 181 000 (një milion e njëqind e tetëdhjetë e një mijë) lekë pa tvsh**, lloji i procedurës: **E hapur e thjeshtuar**.

Ato do të shërbejnë për njohjen e plotë të gjendjes financiare të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen me sukses të kontratës.

Kërkesat e veçanta të kualifikimit të mësipërme përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me LPP i ndryshuar dhe VKM nr.285 datë 19.5.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar. Kriteret e hartuara janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Për secilin kriter janë përcaktuar dokumentet konkretë që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e atyre kriterëve.

II. Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë

cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4 pika 38/b dhe nenit 36 të LPP i ndryshuar si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36 të LPP i ndryshuar. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

KLLFLST NUK KA PARAQITUR SPECIFIKIME TEKNIKE PER KETE OBJEKT PROKURIMI.

Argumentim Anëtarët pranuan procesverbalin të hartuara nga Komisioni i posacëm: **KLLFLST (Komisioni i llogaritjes të fondit limit dhe specifikimeve teknike)** i ngritur me Urdhër të titullarit të Autoritetit Kontraktor **nr. 1375 prot datë 19.02.2025**, duke konsideruar se ato shprehin qartë kërkesat e autoritetit kontraktor për mallrat që do të blejë. Preventivi është hartuar nga specialistet e fushës konkretisht nga KLLFLST, dorëzuar dokumentacioni teknik si preventivi me **procesverbalin e komisionit nr. 1375/1 prot datë 20.02.2025** si dhe **relacioni shpjegues me nr.1375/2 prot 20.02.2025** te cilat shprehin qarte kerkesat e autoritetit kontraktor për cilësinë e të gjitha mallrave.

Preventivi i hartuara nga KLLFLST si më poshtë për objektin

PREVENTIVI

Pjese kembimi,goma bateri dhe mirmbajtje mjetesh

Nr	Emertimi	Njesia	Sasia
A	AB206NC		
1	RiparimMotorrike	sherbim	1
2	Riparimfren	sherbim	1
3	Jastekajri	cope	4
4	Amortizatore	cope	4
5	Riparimkondicioneri+ mbushje me gas	sherbim	1
6	filter kondicioneri	sherbim	1
7	Antifriz	litra	15
8	Riparimfrenash+ferrota	sherbim	4
9	Bateri	cope	1
10	Goma	cope	4

B	AA100 OC		
1	F-V Filter ajri	cope	1
2	F-V Filter vaj	cope	1
3	F-V Filter nafte	cope	1
4	F-V Filtërkamjo (heqje-vendosje)	cope	1
5	vajkamjo	ml	8
6	Nderrimvajmotorri	liter	20
7	RiparimMotorrike	sherbim	1
8	Riparimfren	sherbim	1
9	Amortizatore	cope	4
10	Riparim I sistemit elektrik	sherbim	1
11	Riparimkondicioneri+ mbushje me gas	sherbim	1
12	filter kondicioneri	sherbim	1
13	Antifriz	litra	14
14	Riparimfrenash+ferrota	sherbim	1
15	Bateri	cope	1
16	Goma	cope	4
D	AA701DR		
1	F-V Filter ajri	cope	1
2	F-V Filter vaj	cope	1
3	F-V Filter nafte	cope	1
4	F-V Filtërkamjo (heqje-vendosje)	cope	1
5	vajkamjo	ml	8
6	Nderrimvajmotorri	liter	20
7	RiparimMotorrike	sherbim	1
8	Riparimfren	sherbim	1
9	Amortizatore	cope	4
10	Riparimkondicioneri+ mbushje me gas	sherbim	1
11	filter kondicioneri	cope	1
12	Antifriz	litra	14
13	Riparimfrenash+ferrota	sherbim	1
14	Bateri	cope	1
15	Goma	cope	4
16	Riparim I sistemit elektrik	sherbim	1
17	Fshirsexhamash	cope	2

	Emertimi	Njesia	Sasia
1	Filter Ajri	copë	2

2	Filter Vaji	copë	2
3	Filter Nafte	copë	2
4	Filter kondicioneri	copë	2
5	Bateri 125	copë	2
6	Goma per makinenzjarrfikse 10R.22.5	copë	2
7	Rregullimsistemfrenimi	Here	1

Afatet e lëvrimit: Fillon nga data e lidhjes së kontratës dhe mbaron deri më **12 (dymbëdhjetë) muaj**.

Dokumentacioni pasi u firmos nga të tre anëtarët e Njesisë së Prokurimit, pasi u përpilua edhe formulari përmbledhës i njoftimit të kontratës, do ti paraqitet titullarit të autoritetit kontraktor për tu firmosur dhe u ra dakort që të hidhen në formatin e sistemit elektronik nga personi përgjegjës i prokurimeve anëtar i NJ.P, për shpallje dhe botim nga APP.

NJËSIA E PROKURIMIT: